Dëmet shëndetësore nga ndotja e ajrit në PRISHTINË

Si e dobëson cilësinë e ajrit prodhimi prodhimi i energjisë nga qymyri dhe rreziqet shëndetësore

Ndotësit e ajrit, gazrat dhe grimcat në atmosferë ndikojnë fuqishëm në shëndetin e njeriut, klimën dhe mjedisin. Ajri në qytetet e Ballkanit Perëndimor është zakonisht i dendur me tymra të shkarkimit, tym industrial ose blozë nga termocentralet e qymyrit, veçanërisht gjatë stinës së vjeshtës dhe dimrit. Ndotja e ajrit është rreziku i më i madh për shëndetindhe një nga shkaktarët kryesor të vdekjeve dhe sëmundjeve në nivel global, si dhe në rajon. Cilësia e dobët e ajrit është poashtu faktor kryesor i riskut për sëmundjet kryesore kronike tek të rriturit, duke përfshirë sëmundjet e zemrës dhe mushkërive, si dhe kancerin. Derisa secili prej nesh rrezikohet nga cilësia e dobët e ajrit, disa grupe në qytete, duke përfshirë fëmijët, të moshuarit dhe ata që tashmë vuajnë nga sëmundjet, janë veçanërisht të cenueshëm.

Ulja e niveleve të ndotjes së ajrit, duke ndjekur rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, çdo vit mund të parandalojë një numër të konsiderueshëm të sëmundjeve kronike dhe vdekjeve të hershme në qytete. Vendimmarrësit duhet të jenë më ambicioz në zbatimin e zotimeve të kahmotshme për të përmirësuar cilësinë e ajrit. Kjo seri e informimeve të HEAL synon të shfaqë burimet e ndotjes së ajrit në katër qytete në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe të nxjerrë në pah pse eliminimi i përdorimit të qymyrit për prodhimin e energjisë dhe përfundimit të përdorimit të lëndëve djegëse fosile do të ishte e dobishme veçanërisht për banorët e qytetit.

Rajoni i Prishtinës ka një sipërfaqe prej 572 kilometra katrorë, e ndarë në 43 lagje. Sipas të dhënave të vitit 2019, në territorin e Prishtinës jetojnë 216.870 banorë të përhershëm. Mosha mesatare e banorëve në vitin 2011 është vlerësuar të jetë 30,2 vjet[1].

Cilësia e dobët e ajrit është problem i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit dhe dhe në pikun e ndotjes. Ndotja e ajrit prek Prishtinën më së shumti gjatë stinëve të vjeshtës dhe dimrit për shkak të rritjes së djegies së karburanteve fosile. Në vitin 2020[2], piku i ndotjes pa përqendrim prej 367,2 μg/m^3 të PM_{10}, përqendrime prej 234,5 μg/m^3 të $PM_{2.5}$, përqendrime prej 206,5 μg/m^3 të NO_2dhe nivele të SO_2 prej 294,8 μg/m^3.

[1] "Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës", 2020, Agjencia e Statistikave të Kosovës https://ask.rks-gov.net/media/5641/vjetari-2020-final-per-web-ang.pdf

[2] Të dhënat nga stacionet monitoruese, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, 2021 https://airqualitykosova.rks-gov.net/en/reports-for-the-monitoring-stations/

Si kontribuojnë termocentralet në cilësinë e dobët të ajrit në Prishtinë?

Burimet e ndotjes së ajrit që ndikojnë në cilësinë e ajrit në këtë qytet përfshijnë aktivitetet industriale, transporti, prodhimi i energjisë, energjia dhe ngrohja për amvisëri, aktivitetet bujqësore dhe deponitë. Prishtina është kryeqyteti i Kosovës dhe prodhimi i energjisë nga qymyri në vend ka rënduar shëndetin publik, ekonominë dhe mjedisin për dekada.

Shqetësim i veçantë për mbrojtjen e shëndetit në Prishtinë janë emetimet nga dy termocentralet e mëdha të thëngjillit Kosova A dhe Kosova B, të vendosura rreth 9 dhe 14 kilometra nga qendra e qytetit. Sipas raportit "Comply or Close"[3], Kosova A dhe Kosova B kanë shkelur kufijtë e emetimit për dioksidin e squfurit (SO_2), oksideve të azotit (NO_x) dhe grimcave (PM) në vitin 2020. Emetimet e SO2 ishin 1.8 herë mbi kufirin kombëtar në vitin 2020, në një vlerë absolute prej 19,987 ton. Emetimet e NO_x në Kosovë gjithashtu u rritën ndjeshëm ndërmjet 2018 dhe 2020 – ato arritën në 22,846 ton, gati 3,700-ton më shumë se në vitin 2018. Në vitin 2020, emetimet e PM ishin 4,25 herë mbi kufirin kombëtar në 5,867-ton 5,867 ton, një rritje prej 5,867-ton 5104 ton.



[3] "Pajtohuni ose Mbyllni", Bankwatch, 2021
https://www.complyorclose.org/wp-content/uploads/2021/09/En-COMPLY-OR-CLOSE-web.pdf

Ndikimet shëndetësore të ndotjes së ajrit

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) thotë se asnjë nivel i ndotjes së ajrit nuk mund të konsiderohet 'i sigurt' dhe se lidhja mes ndotjes së ajrit dhe sëmundjeve të frymëmarrjes dhe kardiovaskulare është vërtetuar mirë. Grimcat me madhësi 10 mikrometra (PM_{10}) ose 2,5 mikrometra e më pak ($PM_{2,5}$) çojnë në ngarkesën më të madhe shëndetësore. Përqendrimet mesatare vjetore të PM në Prishtinë janë dukshëm më të larta se sa rekomandon Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH)[4]. Në vitin 2020[5], përqendrimi mesatar vjetor të PM10 u dyfishua dhe ishte pothuajse pesë herë më i lartë për $PM_{2.5}$ krahasuar me udhëzimet e OBSH-së.

Figura 1 Mesatarja vjetore e grimcave në Prishtinë në vitin 2020 krahasuar me rekomandimet e OBSH-së



[4] Udhëzimet globale të cilësisë së ajrit të OBSH-së, Organizata Botërore e Shëndetësisë https://www.who.int/news/item/22-09-2021-new-who-global-air-quality-guidelines-aim-to-save-millions-of-lives-from-air-pollution

[5] Statistikat vjetore, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, 2021 https://airqualitykosova.rks-gov.net/en/annual-statistics/

Tabela 1 Prishtina - Annual average concentrations (µg/m³)

YEAR 2020	$PM_{2.5}$	PM_{10}	NO_2
STACIONI: PRISHTINË, KHM	24	32.5	20.3
STACIONI: PRISHTINË, RILINDJA	22.9	37.4	26
Mesatarja	**23.45**	**34.95**	**23.15**
Rekomandimi i OBSH-së	**5**	**15**	**10**
Përqendrimet	**4.7 herë më** i lartë se rekomandimi i OBSH-së	**2.3 herë më** i lartë se rekomandimi i OBSH-së	**2.3 herë më** i lartë se rekomandimi i OBSH-së

Burimi: https://airqualitykosova.rks-gov.net/en/annual-statistics/

Thithja e grimcave, qoftë edhe në sasi të ulëta, mund të çojë në ndryshime fiziologjike në trup që dëmtojnë shëndetin. Kur thithen, grimcat futen në qarkullimin e gjakut dhe shkaktojnë dëm në mushkëritë dhe zemër. Ato mund të shkaktojnë goditje në tru dhe të çojnë në vdekje të parakohshme. Studimet gjithashtu i lidhin grimcat me dëmtimin e zhvillimit të shëndetshëm të fëmijëve dhe sëmundjeve të tilla si obeziteti dhe Alzheimer. Cilësia e dobët e ajrit lidhet edhe me sëmundjet kronike dhe akute të frymëmarrjes, të cilat zvogëlojn ndjeshëm cilësinë e jetës, si bronkiti dhe përkeqësimi i astmës. Shkencëtarët vazhdojnë të identifikojnë mënyra të reja sesi ndotja e ajrit mund të dëmtojë shëndetin, për shembull, ka rritje të provave që lidhin ndotjen e ajrit me demencën, si dhe kanë treguar se grimcat e ndotjes së ajrit udhëtojnë nëpër mushkëritë e grave shtatzëna dhe vendosen në placentën e tyre, duke dëmtuar foshnjat para se të lindin.

Studimet më të reja tregojnë se edhe nivelet më të ulëta të ndotjes së ajrit shkaktojnë dëme të konsiderueshme për shëndetin. Bazuar në këto njohuri të reja shkencore[6], OBSH ka rishikuar së fundmi udhëzimet e tyre për cilësinë e ajrit. Ato rekomandojnë vlera më të ulëta për disa ndotës, posaçërisht për grimcat $PM_{2.5}$, të cilat shkaktojnë problemet më të mëdha shëndetësore, për të cilat tani rekomandohet një përqendrim i ri vjetor prej 5µg/m³, ndërsa për dioksidin e azotit (NO_2), i cili ka ardhur nën një shqyrtim intensiv në diskutimet mbi transportin rrugor dhe ndalimin e drejtimit të automjeteve brenda qytetit, tani rekomandohet një përqendrim i ri vjetor prej 10µg/m³ (nga 40µg/m³ që ishte më parë).

Fatura shëndetësore e kësaj cilësie të vazhdueshme të dobët e ajrit është e konsiderueshme: Sipas raportit të Agjencisë Evropiane të Mjedisit për cilësinë e ajrit në Evropë 2020, në vitin 2018 Kosova pësoi 4000 vdekje të parakohshme vetëm për shkak të ndotjes me PM[7].

[6] Udhëzimet globale të cilësisë së ajrit të OBSH-së, Organizata Botërore e Shëndetësisë https://www.who.int/news/item/22-09-2021-new-who-global-air-quality-guidelines-aim-to-save-millions-of-lives-from-air-pollution

[7] Cilësia e ajrit në Evropë 2020, Agjencia Evropiane e Mjedisit 2020 https://www.eea.europa.eu/publications/air-quality-in-europe-2020-report

Ndikimet e ndryshimeve klimatike në shëndet

Ndryshimet klimatike pritet t'i përkeqësojnë gjërat: Sipas raportit të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës[8], që nga viti 1900 e deri më sot ka pasur lëvizje të temperaturave mesatare vjetore me trend rritës. Kështu temperatura mesatare vjetore për periudhën 1930-1990 ishte 8,6^{o}C, për periudhën 1990-2002 ishte 9°C, ndërsa për periudhën 2003-2019, mbi 10°C.

Rritja e nivelit të emetimeve të gazrave serrë ndikon në atmosferë dhe sipërfaqe e cila më vonë, nga ana tjetër, shpie në ndryshime klimatike. Është vërtetuar mirë se gjatë valëve të të nxehtit ndotja e ajrit rritet gjithashtu (p.sh. nivelet e ozonit, i cili është një tjetër ndotës që dëmton shëndetin). Emetimet e substancave që shkatërrojnë ozonin janë në vazhdimësi në rritëje për NO_x dhe komponimet organike të paqëndrueshme jo-metan, si dhe për CO.

Në Kosovë, emetimet totale të gazeve serrë variojnë ndërmjet 9,489 Gg CO_2 eq. (2008) dhe 10,164 Gg CO_2 eq. (2016). Emetimet varen kryesisht nga kërkesa për energji dhe aktivitetet e sektorit të energjisë që është burimi kryesor i CO_2 në nivel kombëtar, i cili vjen kryesisht nga dy termocentralet me qymyr. Kosova ka emetime më të larta të CO_2 se disa nga vendet e rajonit.

Rreziqet e shumta të ndryshimeve klimatike kërcënojnë të ndryshojnë progresin e mjedisit dhe shëndetit publik[9]. Trajtimi i ndryshimeve klimatike kërkon që vendimmarrësit të ofrojnë një përgjigje të koordinuar për të siguruar një kalim drejt një të ardhmeje më të shëndetshme[10]. Djegia e lëndëve fosile është përgjegjëse për më shumë se gjysmën e ndotjes së karbonit në qytete në mbarë botën. Qymyri është kontribuesi më i madh në ndryshimet klimatike antropogjene.

Kryebashkiakët aktivë për qytete të shëndetshme, ajër të pastër dhe heqje dorë nga karburantet fosile

Duke qenë të shqetësuar për efektet e industrisë së karburanteve fosile, kryebashkiakët anembanë globit në rrjetin C40 kanë rënë dakord të fillojnë "gjelbërimin" e qyteteve në mënyrë që të zgjerojnë marrjen dhe qasjen në energji elektrike të pastër dhe të përballueshme për miliona banorë urbanë[11]. Rritja e burimeve të ripërtrishme të energjisë çon në përfitime të shumta që rezultojnë në zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike dhe ofrojnë mjedis më të shëndetshëm për të gjithë.

Për t'iu bashkuar përpjekjes globale, kryetarët e nëntë komunave pjesëmarrëse në Ballkanin Perëndimor (Bosnjë dhe Hercegovinë: Banovići, Kakanj, Lukavac, Maglaj, Tuzla; Serbi: Novi Sad, Nish; Mali i Zi: Pljevlja; Maqedonia e Veriut: Manastiri) janë zotuar që të ndërmarrin masa vullnetare që synojnë të reduktojnë ndotjen e ajrit në komunat e tyre në kuadër të 'Iniciativës për Rajonet e Ajrit të Pastër' (Clean Air Regions Initiative - CARI)[12]. Qytetet nën iniciativën CARI do të përpiqen të miratojnë dhe zbatojnë plane lokale të veprimit për cilësinë e ajrit me politika dhe masa ambicioze, të ndajnë përvojat e tyre dhe të mësojnë për progresin dhe arritjet në rajone të tjera. Për fat të keq qyteti i Prishtinës nuk iu bashkua nismës, por ende ka mundësi të zbatohen masa që pastrojnë ajrin dhe mbrojnë shëndetin.

[8] "Mjedisi i Kosovës 2020 - Raport mbi treguesit mjedisorë", Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, 2022 https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Mjedisi_i_Kosov%C3%ABs_2020_Raport_i_treguesve_mjedisor%C3%AB_-_ANGLISHT.pdf

[9] Raporti 2021 i Lancet Countdown mbi shëndetin dhe ndryshimet klimatike: kodi i kuq për një të ardhme të shëndetshme, The Lancet https://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736(21)01787-6/fulltext

[10] Infografia e ndryshimeve klimatike, Aleanca e Shëndetit dhe Mjedisit https://www.env-health.org/wp-content/uploads/2019/11/Climate-Change-Health-Infographic-V3.pdf

[11] Deklarata e Energjisë së Rinovueshme C40, Qytetet C40 https://www.c40.org/press_releases/renewable-energy-declaration

[12] Deklarata "Iniciativa për Rajonet e Ajrit të Pastër (CARI)", Komuniteti i Energjisë https://www.energy-community.org/news/Energy-Community-News/2021/07/1.html

Rekomandimet

AUTORITETEVE TË QYTETIT

Të vendoset plani i veprimit për ajër të pastër dhe shëndetin, duke përfshirë rrugën për të arritur rekomandimet e OBSH-së për cilësinë e ajrit dhe trajtimin e burimeve kryesore të ndotjes.

Të bëhet zgjedhje të mirëinformuara të energjisë bazuar në vlerësimet e ndikimit në shëndet dhe mjedis, si dhe analizat ekonomike për mirëqenien e qytetit e Prishtinës. Qytetet që mbështeten në lëndë fosile nuk janë zgjidhje miqësore me mjedisin për një të ardhme më të shëndetshme.

Vetëdijësim për kontributin e termocentraleve të thëngjillit në cilësinë e dobët të ajrit në Prishtinë dhe të avokohet për largimi nga qymyri. Kjo do të çojë në përfitime të shëndetit publik, si dhe në ulje të kostos.

Krijimi i një task force me shumë agjenci në mënyrë që të gjitha palët përkatëse të mund të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së ajrit, duke bërë kërkime mbi implikimet shëndetësore dhe financiare ,duke u siguruar që veprimet do të çojnë në rezultatet më të mira.

Rritja e mbulimit të monitorimit të cilësisë së ajrit dhe vënia në dispozicion të të dhënave 24/7 në mënyrë që qytetarët të ndjekin rekomandimet për të shmangur rreziqet shëndetësore. Autoritetet e qytetit duhet të zbatojnë masat e menaxhimit të riskut nga ndotja eajrit për të ruajtur sigurinë qytetare.

Të inicohen fushata publike për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për ndikimet shëndetësore nga ndotja e ajrit. Autoritetet e qytetit duhet të japin informacion për reduktimin e ekspozimit ndaj ndotjes së ajrit.

KOMUNITETIT SHËNDETËSOR

Rritja e pjesëmarrjes së ekspertëve shëndetësorë në proceset vendimmarrëse për të siguruar përditësimin e zbatimit të masave parandaluese. Vendimet duhet të merren në kohë reale. Veprimet në kohë do të parandalojnë sëmundjet kronike dhe vdekjen e parakohshme.

Gjatë diskutimeve publike dhe marrjes së vendimeve në nivel lokal të vehet në pah kostoja e vërtetë e prodhimit të energjisë nga qymyrit në shëndetin, si dhe të avokohet drejt rritjes së vetëdijes publike se si shëndeti publik do të përfitojë nga ulja e faturave të papaguara shëndetësore të qymyrit.

Si një komunitet shëndetësor, kontribuoni në zhvillimin e veprimeve për ajër të pastër, si dhe në politikat e energjisë dhe klimës, dhe mbështesni zbatimin e masave për të reduktuar ndotjen nga qymyri.

Komunikoni me pacientët dhe publikun lidhjet mes ndotjes së ajrit dhe shëndetit, dhe se si përmirësimet e cilësisë së ajrit do të rezultojnë në shëndet më të mirë.

Promovoni veprime të forta klimatike për të minimizuar ndikimet e nxehtësisë dhe veprimeve ekstreme të motit.

Autori: Srdjan Kukolj

Ekipi redaktues: Anne Stauffer, Vlatka Matkovic dhe Elke Zander

Shfrytëzojmë rastin që të falënderojmë Viktor Berishaj për recenzion dhe kontributin e tij në këtë punim.

Health and Environment Alliance (HEAL)
Avenue des Arts 7/8
1210 Brussels, Belgium
Telefoni: +32 (0)2 329 00 80
E-mail: info@env-health.org

Kontaktoni:
Vlatka Matkovic, Zyrtare e Lartë për Politikat e Shëndetësisë dhe Energjisë,
E-mail: vlatka@env-health.org
Srdjan Kukolj, Konsulent, rajoni i Ballkanit
E-mail: srdjan@env-health.org

@HealthandEnv
@healthandenvironmentalliance

HEAL gratefully acknowledges the financial support of the European Union (EU) and the European Climate Foundation (ECF) for the production of this publication. The responsibility for the content lies with the authors and the views expressed in this publication do not necessarily reflect the views of the EU institutions and funders. The European Climate, Infrastructure and Environment Executive Agency (CINEA) and the funders are not responsible for any use that may be made of the information contained in this publication.

HEAL EU transparency register number: 00723343929-96